



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr.2, datë 14.06.2024

“Për organizimin e bashkëpunimit me Organizatat e Shoqërisë Civile, Organizatat e Biznesit, Botës Akademike dhe Grupeve të Interesit, për përfshirjen aktive me kontribute dhe në nivel ekspertësh në përmbushjen e qëllimit dhe objektivit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar

Bazuar në nenin 24 e vijues të Regullores së Kuvendit dhe në pikën VIII, paragrafi 1, të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të kryetarit, Komisioni i Posaçëm

VENDOSI:

1. T’u drejtohet me një Ftesë për bashkëpunim Organizatave të Shoqërisë civile, Organizatave të Biznesit, Botës Akademike (Universiteteve publike e jo publike) dhe grupeve të interesit për të shprehur interesin për përfshirje aktive në nivel ekspertësh dhe Sekretariatit Teknik, në tryezat e debatit publik si dhe për të kontribuar me të dhëna të ndryshme (analiza, strategji, plane veprimi etj) për fushat që lidhen me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së këtij komisioni.
2. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për t’u komunikuar si më sipër institucioneve e organizatave përkatëse vendimin e Kuvendit, objektin e punës së komisionit, organizimin dhe kohën e veprimtarisë së tij, si dhe numrin e cilësitë e domosdoshme që duhet të përmbushin ekspertët dhe specialistët për t’u përfshirë në Grupet e Ekspertëve dhe Sekretariatit Teknik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ

Miratuar me 14.06.2024